RELACION

"PËR
PËRCAKTIMIN E MASAVE, LISTËS SË PRODUKTEVE PLASTIKE NJËPËRDORIMËSHE TË CILAT NDALOHET TË PËRDOREN, TË HIDHEN NË TREG, TË PRODHOHEN OSE TË IMPORTOHEN, INSTITUCIONET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE DHE MIRATIMIN E KRITEREVE DHE MASAVE TË NEVOJSHME PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS TË DISA LLOJEVE TË PRODUKTEVE PLASTIKE NJËPËRDORIMËSHE".

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi "Për përcaktimin e masave, listën e produkteve plastike njëpërdorimëshe, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe" hartohet në kuadër të nevojës për forcimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë problematikën në rritje të ndotjes nga produktet plastike njëpërdorimëshe. Ky projektakt synon të ndërtojë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, nëpërmjet përcaktimit të masave konkrete rregullatore, ekonomike dhe ndërgjegjësuese, ku do të synoj reduktimin e ndikimit negativ të këtyre produkteve në mjedis, veçanërisht në mjedisin ujor, si dhe në shëndetin e njeriut.

Qëllimi themelor i projektvendimit është përafrimi i plotë i legjislacionit vendas me acquis të Bashkimit Evropian, konkretisht me Direktivën (BE) 2019/904 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2019, "Mbi reduktimin e ndikimit të produkteve të caktuara plastike në mjedis". Në këtë kuadër, projektvendimi nuk kufizohet vetëm në një harmonizim formal të dispozitave, por synon një përputhshmëri të plotë substanciale, duke reflektuar parimet, kërkesat dhe standardet e përcaktuara në këtë direktivë.

Projekt-aktit lidhet ngushtë me zbatimin efektiv të dispozitave të Ligjit nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", duke krijuar një kuadër të

plotë për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve plastike dhe përmirësimin e menaxhimit të tyre përgjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve.

Në funksion të këtij qëllimi, projektvendimi synon të vendosë masa konkrete për kufizimin, prodhimin, ndalimin apo reduktimin e produkteve plastike të identifikuara si më problematike për mjedisin, si dhe të nxisë përdorimin e alternativave të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Njëkohësisht, ai parashikon forcimin e përgjegjësisë së prodhuesve dhe subjekteve të tjera të përfshira në ciklin e jetës së produkteve plastike, duke promovuar parimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Një objektiv i rëndësishëm i projektaktit është edhe rritja e ndërgjegjësimit publik dhe institucional mbi ndikimet negative që kanë produktet plastike në mjedis dhe shëndetin e njeriut, si dhe nxitja e ndryshimit të sjelljes së konsumatorëve drejt praktikave më të qëndrueshme. Në këtë drejtim, projektvendimi synon të krijojë mekanizma të qartë informimi, edukimi dhe sensibilizimi.

Gjithashtu, projektvendimi ka për objektiv përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit, në mënyrë që të sigurohet ndjekja efektive e zbatimit të masave të parashikuara dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në praktikë. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të institucioneve përkatëse, si dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional, përbëjnë elementë thelbësorë për garantimin e një zbatimi të suksesshëm të këtij akti.

Në këtë kuadër, shtojcat bashkëlidhur projektvendimit luajnë një rol të veçantë, pasi ato përmbajnë listat e produkteve të përfshira, kriteret teknike, si dhe format dhe procedurat që do të ndiqen për zbatimin e dispozitave përkatëse, duke siguruar një nivel të lartë qartësie dhe zbatueshmërie në praktikë.

Në përfundim, projektvendimi synon të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, reduktimin e ndotjes nga plastika dhe afrimin e standardeve kombëtare me ato evropiane, duke përmbushur njëkohësisht detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian dhe duke krijuar bazat për një zhvillim më të qëndrueshëm.

Në mënyrë më specifike, projektvendimi synon të arrijë këto objektiva:

Së pari, reduktimin e konsumit të produkteve plastike njëpërdorimëshe përmes vendosjes së objektivave të matshëme dhe afateve kohore konkrete, duke synuar një ulje të qëndrueshme deri në vitin 2030 krahasuar me nivelin e vitit 2026. Ky

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masave, listës së produkteve plastike njëpërdorimëshe të cilat ndalohet të përdoren, të hidhen në treg, të prodhohen ose të importohen, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe".

reduktim do të realizohet përmes kombinimit të instrumenteve ekonomike, kufizimeve në tregtim dhe promovimit të alternativave të ripërdorshme.

Së dyti, parandalimin e vendosjes në treg të produkteve plastike më problematike, si ato të listuara në pjesën përkatëse të aneksit, përfshirë edhe plastikën oxo-degraduese, e cila kontribuon në ndotjen me mikroplastikë. Kjo masë synon të nxisë zëvendësimin e tyre me produkte më të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Së treti, forcimin e përgjegjësisë së prodhuesve dhe importuesve përmes zbatimit të skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR), duke i detyruar ata të mbulojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve, përfshirë grumbullimin, transportin, trajtimin dhe pastrimin e mjedisit nga mbetjet e krijuara nga produktet e tyre.

Së katërti, përmirësimin e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve përmes vendosjes së kërkesave të detyrueshme për markimin e produkteve, si dhe zhvillimit të fushatave informuese mbi ndikimet negative të plastikës dhe mënyrat e duhura të menaxhimit të mbetjeve.

Së pesti, rritjen e niveleve të riciklimit dhe përdorimit të materialeve të ricikluara, veçanërisht në sektorin e ambalazheve të pijeve, duke kontribuar në kalimin drejt një ekonomie qarkulluese dhe në përdorimin më efikas të burimeve natyrore.

Së gjashti, projektvendimi synon të përmirësojë sistemin e monitorimit dhe raportimit për produktet plastike njëpërdorimëshe, duke siguruar të dhëna të sakta dhe të besueshme për hartimin e politikave të ardhshme dhe për vlerësimin e progresit të arritur.

Në tërësi, ky projekt-akt synon të krijojë një balancë ndërmjet mbrojtjes së mjedisit, funksionimit të tregut dhe interesave të konsumatorëve, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masave, listës së produkteve plastike njëpërdorimëshe të cilat ndalohet të përdoren, të hidhen në treg, të prodhohen ose të importohen, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe".

Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2026, dhe është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi "Për përcaktimin e masave, listën e produkteve plastike njëpërdorimëshe, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe", paraqet një ndërhyrje të domosdoshme në kushtet e rritjes së ndjeshme të ndotjes nga plastika njëpërdorimëshe në Shqipëri, veçanërisht në mjediset ujore dhe urbane. Argumentimi i tij mbështetet në nevojën për të adresuar boshllëqet ekzistuese në kuadrin rregullator dhe për të garantuar një qasje më të integruar dhe parandaluese ndaj menaxhimit të mbetjeve plastike.

Një nga përparësitë kryesore të projektvendimit qëndron në përafrimin e plotë me Direktivën (BE) 2019/904, duke siguruar kështu harmonizimin e legjislacionit vendas me standardet e Bashkimit Evropian. Ky përafrim kontribuon drejtpërdrejt në avancimin e procesit të integrimit, ndërkohë që krijon një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e politikave mjedisore afatgjata. Për më tepër, projektvendimi sjell qartësi më të madhe ligjore, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar kategoritë e produkteve plastike që ndalohen, kufizohen apo i nënshtrohen masave të veçanta, si dhe detyrimet përkatëse për subjektet e përfshira.

Projektvendimi mundëson krijimin e një kuadri të qartë dhe të detajuar rregullator për menaxhimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe. Përmes përcaktimit të masave konkrete si ndalimi i disa produkteve, vendosja e kërkesave për markim dhe futja e instrumenteve ekonomike, sigurohet një qasje e strukturuar dhe efektive për reduktimin e ndotjes. Projekt-akti forcon parimin "ndotësi paguan" duke vendosur detyrime të qarta për prodhuesit dhe importuesit nëpërmjet skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Kjo pritet të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe në uljen e barrës financiare për autoritetet publike.

Një tjetër përparësi është nxitja e inovacionit dhe kalimit drejt alternativave të qëndrueshme. Duke kufizuar produktet plastike problematike dhe duke promovuar produkte të ripërdorshme apo të biodegradueshme, projektvendimi krijon kushte për zhvillimin e një ekonomie qarkulluese dhe për rritjen e konkurrueshmërisë së tregut.

Po ashtu, përmirësimi i informimit të konsumatorëve përmes kërkesave të detyrueshme për markim dhe fushatave ndërgjegjësuese ndihmon në ndryshimin e sjelljes së tyre drejt praktikave më të përgjegjshme mjedisore.

Problematikat që adreson projekt-akti, ka të bëjë me disa problematika thelbësore që karakterizojnë situatën aktuale në Shqipëri.

Së pari, niveli i lartë i përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe dhe mungesa e alternativave të përhapura ka çuar në rritjen e ndjeshme të mbetjeve plastike në mjedis.

Së dyti, menaxhimi i pamjaftueshëm i mbetjeve, përfshirë mungesën e sistemeve efikase të grumbullimit dhe riciklimit, ka kontribuar në përhapjen e ndotjes, veçanërisht në zonat bregdetare dhe ujore.

Së treti, mungesa e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë të prodhuesve për ciklin e plotë jetësor të produkteve ka krijuar një barrë të konsiderueshme për pushtetin vendor dhe buxhetin publik.

Gjithashtu, niveli i ulët i ndërgjegjësimit të publikut për ndikimet negative të plastikës dhe për praktikat e duhura të menaxhimit të mbetjeve përbën një sfidë të rëndësishme që ky projekt-akt synon ta adresojë.

Efektet e pritshme të këtij projektvendimi parashikohen të jenë një ndikim i ndjeshëm pozitiv në reduktimin e ndotjes mjedisore, veçanërisht në uljen e sasisë së mbetjeve plastike që përfundojnë në mjedis, në tokë dhe në ujëra. Ai gjithashtu pritet të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mbrojtjen e shëndetit publik, duke reduktuar ekspozimin ndaj materialeve të dëmshme.

Zbatimi i këtij projektvendimi pritet të sjellë një sërë efektesh pozitive në plan afatshkurtër dhe afatgjatë. Në plan mjedisor, pritet reduktimi i ndjeshëm i ndotjes nga plastika, veçanërisht në mjedisin detar dhe ujërat e brendshme, si dhe ulja e sasisë së mbetjeve të hedhura në mënyrë të pakontrolluar.

Në plan ekonomik, projekt-akti pritet të stimulojë zhvillimin e sektorëve të rinj që lidhen me riciklimin dhe prodhimin e alternativave të qëndrueshme, duke krijuar mundësi të reja punësimi dhe investimi. Ndërkohë, në afat të gjatë, pritet ulja e kostove për menaxhimin e mbetjeve për autoritetet publike.

Në plan social, rritja e ndërgjegjësimit dhe ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Në plan institucional, projektvendimi forcon kapacitetet monitoruese dhe raportuese të institucioneve përgjegjëse, duke mundësuar një vlerësim më të saktë të progresit dhe një hartim më efektiv të politikave në të ardhmen.

Në përfundim, projekt-akti paraqet një instrument të rëndësishëm për adresimin e një problematike komplekse mjedisore, duke ofruar një qasje të balancuar ndërmjet masave rregullatore, ekonomike dhe edukative, me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMERISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 50, të Ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim përafron plotësisht legjislacionin me Acquis Communautaire me Direktivën (BE) 2019/904 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Qershorit 2019 “Mbi reduktimin e ndikimit të produkteve të caktuara plastike në mjedis”, numri i identifikimit CELEX: 32019l0904, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria l, nr. 155, datë 12.6.2019.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Neni 1 përcakton objektin dhe fushën e zbatimit të këtij projektvendimi, duke vendosur kuadrin rregullator për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit dhe importimit të disa produkteve plastike njëpërdorimëshe, të listuara në Shtojcën I bashkëlidhur vendimit. Gjithashtu, ky nen përcakton kriteret dhe masat e nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të këtyre produkteve në mjedis, si dhe identifikon institucionet shtetërore përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për zbatimin dhe monitorimin e dispozitave të vendimit.
Përmes përcaktimit të qartë të objektit, fushës së zbatimit dhe subjekteve të përfshira, ky nen siguron bazën juridike për ndërmarrjen e masave që synojnë reduktimin e ndotjes nga plastika njëpërdorimëshe dhe promovimin e një ekonomie më të qëndrueshme në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit. Fusha e zbatimit shtrihet mbi produktet plastike njëpërdorimëshe të listuara në Shtojcën I, produktet prej plastike oxo-degradueshme dhe pajisjet e peshkimit që përmbajnë plastikë, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj burimeve kryesore të ndotjes plastike.
Në aspektin e përafrimit të legjislacionit, ky nen reflekton objektivat dhe fushën e zbatimit të Direktivës (BE) 2019/904 për reduktimin e ndikimit të produkteve të caktuara plastike në mjedis, duke siguruar që kategoritë e produkteve me ndikimin më të lartë mjedisor të përfshihen në mekanizmat kombëtarë të kontrollit, monitorimit dhe zbatimit.

Neni 2 përcakton objektivat kryesore të këtij projektvendimi, të cilat konsistojnë në parandalimin dhe reduktimin e ndikimit negativ të produkteve plastike njëpërdorimëshe në mjedis, veçanërisht në mjedisin ujor, si dhe në mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga efektet e ndotjes plastike. Në të njëjtën kohë, ky nen synon të nxisë kalimin drejt një ekonomie qarkulluese, duke promovuar zhvillimin dhe përdorimin e modeleve të qëndrueshme të biznesit, produkteve dhe materialeve inovative që reduktojnë varësinë nga plastika njëpërdorimëshe.
Ky nen transpozon objektivin themelor të Direktivës (BE) 2019/904 për reduktimin e ndikimit të produkteve të caktuara plastike në mjedis, duke e orientuar politikën kombëtare drejt parandalimit të ndotjes në burim dhe përdorimit më efikas të burimeve. Përmes këtyre objektivave, krijohet baza për uljen graduale të mbetjeve plastike, mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe tokësore, si dhe për nxitjen e modeleve të prodhimit dhe konsumit që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.
Gjithashtu, objektivat e parashikuara në këtë nen kontribuojnë në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me politikat mjedisore të Bashkimit Evropian dhe në

përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, veçanërisht në fushën e ekonomisë qarkulluese dhe mbrojtjes së mjedisit.

Neni 3 jep përkufizimet kryesore të përdorura në vendim, duke harmonizuar terminologjinë me legjislacionin në fuqi dhe duke siguruar një interpretim të qartë të termave si plastikë, prodhues, hedhje në treg, plastikë biodegradueshme etj.

Neni 4 përcakton listën e produkteve plastike njëpërdorimëshe që ndalohen për prodhim, importim, vendosje në treg dhe përdorim, sipas Shtojcës I, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Gjithashtu, ky nen vendos kriteret për identifikimin dhe klasifikimin e një produkti si plastikë njëpërdorimëshe, duke siguruar një zbatim të unifikuar dhe të qartë të masave kufizuese të parashikuara në vendim.
Për këtë qëllim, neni përcakton karakteristikat kryesore që dallojnë produktet plastike njëpërdorimëshe nga produktet e ripërdorshme, duke marrë në konsideratë përbërjen e tyre materiale, funksionin, mënyrën e përdorimit dhe destinacionin pas përdorimit. Në mënyrë të veçantë, për enët e ushqimit parashikohen kritere shtesë që lidhen me natyrën e konsumit të menjëhershëm dhe karakteristikat e ushqimit që ato përmbajnë.
Ky nen synon të shmangë paqartësitë në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit, duke krijuar një bazë të qartë ligjore për identifikimin e produkteve që i nënshtrohen ndalimeve dhe kufizimeve të përcaktuara nga ky vendim. Gjithashtu, ai siguron që vlerësimi i produkteve të mos kufizohet vetëm në përbërjen e tyre, por të marrë në konsideratë edhe potencialin e tyre për t'u shpërndarë në mjedis dhe për të kontribuar në ndotjen plastike, veçanërisht në rastin e ambalazheve dhe paketimeve individuale.
Dispozitat e këtij neni janë në përputhje me qasjen e Direktivës (BE) 2019/904, e cila përcakton kritere të harmonizuara për identifikimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe dhe synon garantimin e një zbatimi të njëtrajtshëm të masave për reduktimin e ndikimit të tyre në mjedis në të gjitha shtetet që zbatojnë këtë kuadër rregullator.

Neni 5 përcakton kufizimet mbi vendosjen në treg të produkteve plastike njëpërdorimëshe, duke ndaluar importin dhe hedhjen në treg në Republikën e Shqipërisë të produkteve të listuara në Pjesën B të Shtojcës I, si dhe të produkteve të prodhuara nga plastika oxo-degradueshme. Kjo dispozitë përbën një nga

instrumentet kryesore rregullatore për reduktimin e ndotjes nga plastika, duke synuar eliminimin gradual të produkteve që kanë alternativa më të qëndrueshme dhe me ndikim më të ulët mjedisor.
Përmes këtij ndalimi, synohet ndërprerja e qarkullimit të produkteve që kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në gjenerimin e mbetjeve plastike dhe në ndotjen e mjedisit, veçanërisht të ekosistemeve ujore. Ndalimi i produkteve të prodhuara nga plastika oxo-degradueshme bazohet në faktin se këto materiale nuk biodegradohen plotësisht, por fragmentohen në grimca të vogla plastike, duke kontribuar në rritjen e ndotjes nga mikroplastikat dhe duke krijuar rreziqe afatgjata për mjedisin.
Kjo dispozitë transpozon kërkesat e Direktivës (BE) 2019/904, e cila parashikon ndalimin e vendosjes në treg të disa kategorive të produkteve plastike njëpërdorimëshe për të cilat ekzistojnë alternativa të përshtatshme dhe të disponueshme. Zbatimi i këtij neni kontribuon në reduktimin e mbetjeve plastike në burim, nxit përdorimin e materialeve alternative dhe mbështet objektivat e ekonomisë qarkulluese dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Neni 6 përcakton masat dhe kërkesat teknike që duhet të plotësojnë disa kategori të produkteve plastike njëpërdorimëshe për t'u hedhur në treg. Dispozitat e tij synojnë të reduktojnë gjenerimin e mbetjeve plastike dhe humbjen e komponentëve plastikë në mjedis, si dhe të nxisin përdorimin e materialeve të ricikluara në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese.
Në këtë kuadër, neni parashikon që produktet plastike njëpërdorimëshe të përcaktuara në Pjesën C të Shtojcës I, të cilat kanë tapa ose kapakë prej plastike, mund të hidhen në treg vetëm nëse këta komponentë mbeten të lidhur me kontejnerin gjatë gjithë fazës së përdorimit të produktit. Kjo kërkesë synon të parandalojë shkëputjen dhe shpërndarjen e tapave dhe kapakëve në mjedis, duke reduktuar një nga kategoritë më të zakonshme të mbetjeve plastike që gjenden në ekosistemet ujore dhe bregdetare.
Gjithashtu, neni vendos një kërkesë progresive për përmbajtjen e materialit të ricikluar në shishet plastike të pijeve të listuara në Pjesën F të Shtojcës I. Duke filluar nga data 1 janar 2030, këto produkte duhet të përmbajnë të paktën 30 për qind plastikë të ricikluar, të llogaritur si mesatare për të gjitha shishet plastike njëpërdorimëshe të hedhura në treg. Kjo masë synon të rrisë kërkesën për materiale të ricikluara, të përmirësojë funksionimin e tregut të riciklimit dhe të zvogëlojë përdorimin e lëndëve të para plastike të virgjëra.

Dispozitat e këtij neni transpozojnë kërkesat për dizajnin e produkteve dhe përmbajtjen e materialeve të ricikluara të parashikuara në Direktivën (BE) 2019/904, duke kontribuar në reduktimin e ndotjes plastike, forcimin e ekonomisë qarkulluese dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me standardet e Bashkimit Evropian.

Neni 7 përcakton masat për etiketimin e disa kategorive të produkteve plastike njëpërdorimëshe, me qëllim informimin e konsumatorëve mbi përbërjen e tyre dhe mënyrën e duhur të menaxhimit të mbetjeve pas përdorimit. Kjo dispozitë synon të rrisë ndërgjegjësimin publik dhe të kontribuojë në reduktimin e ndotjes së mjedisit të shkaktuar nga asgjësimi i papërshtatshëm i këtyre produkteve.
Në zbatim të këtij neni, duke filluar nga data 1 janar 2027, produktet e listuara në Pjesën D të Shtojcës I duhet të mbajnë një etiketim të dukshëm, të lexueshëm dhe të pandryshueshëm, të vendosur në ambalazh ose në vetë produktin, sipas rastit. Etiketimi duhet të informojë konsumatorët për praninë e plastikës në produkt, për opsionet e duhura të menaxhimit të mbetjeve dhe për ndikimin negativ që mund të shkaktojë në mjedis hedhja e papërshtatshme e tyre.
Gjithashtu, neni përcakton kërkesat teknike dhe specifikimet e harmonizuara të etiketimit për kategori të caktuara produktesh, si pecetat higjienike, tamponët dhe aplikatorët e tyre, pecetat e lagura për përdorim personal ose shtëpiak, produktet e duhanit me filtra dhe gotat e pijeve. Këto kërkesa sigurojnë një paraqitje të standardizuar të informacionit për konsumatorin dhe garantojnë një nivel të njëtrajtshëm informimi në treg.
Për më tepër, dispozita ndalon prodhimin ose importimin e produkteve të përcaktuara në këtë nen nëse ato nuk janë të pajisura me etiketimin e kërkuar. Kjo masë synon të forcojë zbatimin e detyrimeve ligjore dhe të sigurojë që konsumatorët të marrin informacion të qartë mbi përmbajtjen plastike të produkteve dhe pasojat mjedisore të menaxhimit të papërshtatshëm të mbetjeve të tyre.
Ky nen transpozon kërkesat e Direktivës (BE) 2019/904 lidhur me etiketimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe, duke përdorur informimin e konsumatorit si një instrument të rëndësishëm për parandalimin e ndotjes, ndryshimin e sjelljes së përdoruesve dhe përmirësimin e praktikave të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese.

Neni 8 përcakton masat që lidhen me prodhimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe, duke vendosur kërkesa të detyrueshme për projektimin dhe

përbërjen e tyre me qëllim reduktimin e ndikimit mjedisor dhe nxitjen e përdorimit të materialeve të ricikluara. Këto masa synojnë të harmonizojnë proceset e prodhimit me standardet e Bashkimit Evropian dhe të mbështesin tranzicionin drejt një ekonomie qarkulluese.

Në këtë kuadër, prodhuesit e produkteve plastike njëpërdorimëshe që i nënshtrohen kërkesave të dizajnit janë të detyruar të përshtatin proceset e tyre të prodhimit në përputhje me standardet e harmonizuara evropiane. Kjo siguron që produktet e vendosura në treg të plotësojnë kërkesat teknike dhe mjedisore të parashikuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Neni parashikon gjithashtu kërkesa specifike për enët e pijeve me kapacitet deri në 3 litra, duke përcaktuar se ato mund të prodhohen ose importohen vetëm nëse tapat dhe kapakët prej plastike mbeten të lidhura me enën gjatë gjithë periudhës së përdorimit të saj. Kjo masë synon të reduktojë humbjen e këtyre komponentëve në mjedis dhe të kufizojë shpërndarjen e mbetjeve plastike me përmasa të vogla, të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ndotjes së ekosistemeve ujore dhe bregdetare. Njëkohësisht, neni përcakton përjashtimet nga kjo kërkesë për kategori të caktuara produktesh, si enët prej qelqi ose metali me tapa plastike dhe produktet e destinuara për ushqime për qëllime të veçanta mjekësore.

Për më tepër, dispozita vendos objektiva të detyrueshme për përmbajtjen e materialeve të ricikluara në shishet e pijeve. Në mënyrë progresive, prodhuesit duhet të sigurojnë që shishet PET të përmbajnë të paktën 25 për qind plastikë të ricikluar nga 1 Janari 2030 dhe që të gjitha enët e pijeve të përmbajnë të paktën 30 për qind plastikë të ricikluar deri në vitin 2040. Këto objektiva synojnë të rrisin përdorimin e lëndëve të para të ricikluara, të reduktojnë varësinë nga plastika e virgjër dhe të krijojnë stimuj për zhvillimin e tregut të riciklimit.

Direktiva (BE) 2019/904 parashikon që shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për arritjen e objektivave për përmbajtjen e materialit të ricikluar në shishet e pijeve deri në afatet e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian. Megjithatë, duke marrë në konsideratë nivelin aktual të zhvillimit të infrastrukturës së grumbullimit dhe riciklimit të mbetjeve plastike në Shqipëri, si dhe nevojën për krijimin e kapaciteteve të nevojshme teknike dhe institucionale, në kuadër të Planit të Zbatimit Specifik për Direktivën (RSIP), Shqipëria ka kërkuar një periudhë tranzitore për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Kjo periudhë tranzitore synon të mundësojë ngritjen graduale të sistemeve të grumbullimit të veçantë, funksionalizimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për riciklimin e plastikës, me qëllim arritjen e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e Direktivës.

Neni 9 përcakton masat dhe kushtet që rregullojnë importimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të kërkesave të këtij vendimi dhe parandalimin e hyrjes në treg të produkteve që nuk përmbushin standardet e përcaktuara mjedisore dhe teknike.
Në këtë kuadër, neni ndalon importimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe të përfshira në listën e produkteve të ndaluara, si dhe të produkteve të prodhuara nga plastika oxo-degradueshme. Kjo masë synon të eliminojë në burim hyrjen në tregun shqiptar të produkteve që paraqesin rrezik të lartë për mjedisin dhe që janë objekt i kufizimeve sipas këtij vendimi.
Gjithashtu, dispozita ngarkon autoritetet doganore me detyrën e verifikimit të përputhshmërisë së produkteve të importuara me kërkesat teknike të përcaktuara në vendim. Për këtë qëllim, subjektet importuese duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës që vërteton përmbushjen e kërkesave lidhur me projektimin e produkteve, përfshirë lidhjen e tapave dhe kapakëve me enët e pijeve gjatë përdorimit të tyre, si dhe respektimin e objektivave për përmbajtjen minimale të plastikës së ricikluar.
Neni parashikon gjithashtu kontrollin e kërkesave për etiketimin e produkteve që i nënshtrohen detyrimit të shënjimit, duke kushtëzuar zhdoganimin e tyre me praninë e etiketimit dhe piktogrameve të harmonizuara sipas specifikimeve të përcaktuara në shtojcat e vendimit. Kjo masë garanton që produktet të informojnë në mënyrë të qartë konsumatorët mbi përmbajtjen plastike dhe mënyrën e duhur të menaxhimit të mbetjeve.
Për të siguruar efektivitetin e mekanizmave të kontrollit, neni parashikon bllokimin dhe kthimin në vendin e origjinës të çdo ngarkese që importohet në kundërshtim me kërkesat e këtij vendimi, me shpenzimet e subjektit importues. Kjo dispozitë forcon rolin e autoriteteve doganore si mekanizëm parandalues dhe kontrollues, duke garantuar që vetëm produktet që përmbushin kërkesat ligjore dhe mjedisore të lejohen të hyjnë në tregun shqiptar.
Dispozitat e këtij neni kontribuojnë në zbatimin praktik të kërkesave të Direktivës (BE) 2019/904, duke krijuar mekanizma kontrolli në pikën e hyrjes së mallrave në vend dhe duke siguruar që standardet e përcaktuara për produktet plastike njëpërdorimëshe të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë operatorët ekonomikë.

Neni 10 përcakton masat që synojnë parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe në mjedis përmes informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve. Kjo dispozitë mbështetet në parimin se reduktimi i ndotjes plastike nuk arrihet vetëm përmes kufizimeve dhe kërkesave teknike ndaj produkteve, por edhe përmes ndryshimit të sjelljes së konsumatorëve dhe promovimit të praktikave të qëndrueshme të konsumit.

Në këtë kuadër, prodhuesit detyrohen të ndërmarrin veprime informuese dhe ndërgjegjësuese që synojnë nxitjen e përdorimit të përgjegjshëm të produkteve plastike njëpërdorimëshe dhe reduktimin e hedhjes së tyre të pakontrolluar në mjedis. Këto masa kanë për qëllim të kontribuojnë në uljen e sasisë së mbetjeve plastike që përfundojnë në natyrë dhe të minimizojnë pasojat negative që ato shkaktojnë në ekosisteme.
Gjithashtu, neni kërkon që konsumatorët dhe përdoruesit e produkteve të përcaktuara në Shtojcën I, si dhe përdoruesit e pajisjeve të peshkimit që përmbajnë plastikë, të informohen për alternativat e ripërdorshme, sistemet e ripërdorimit dhe opsionet e disponueshme për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Përmes këtij informacioni synohet të inkurajohet zgjedhja e produkteve me ndikim më të ulët mjedisor dhe të promovohet zbatimi i praktikave që favorizojnë ripërdorimin dhe riciklimin.
Neni parashikon gjithashtu informimin e publikut mbi pasojat mjedisore të hedhjes së paligjshme të mbetjeve dhe të formave të tjera të papërshtatshme të asgjësimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe, veçanërisht në ekosistemet ujore dhe detare. Një rëndësi e veçantë i kushtohet informimit lidhur me ndikimin që këto produkte mund të kenë në funksionimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe në ndotjen e mjedisit kur hidhen në mënyrë të papërshtatshme.
Dispozitat e këtij neni transpozojnë kërkesat e Direktivës (BE) 2019/904 në lidhje me masat e ndërgjegjësimit publik, duke e konsideruar informimin e konsumatorëve si një instrument të rëndësishëm për parandalimin e ndotjes plastike, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe mbështetjen e objektivave të ekonomisë qarkulluese. Përmes këtyre masave synohet krijimi i një kulture më të përgjegjshme mjedisore dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në reduktimin e ndotjes nga plastika.

Neni 11 përcakton kuadrin e masave për zvogëlimin e konsumit të produkteve plastike njëpërdorimëshe, duke vendosur objektiva dhe mekanizma monitorimi

me qëllim reduktimin e qëndrueshëm të përdorimit të tyre dhe minimizimin e ndikimit mjedisor gjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve.
Në këtë kuadër, masat konkrete për arritjen e një reduktimi të qëndrueshëm të konsumit të produkteve plastike njëpërdorimëshe të listuara në Pjesën A të Shtojcës I përcaktohen në Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve. Ky program përbën instrumentin kryesor planifikues për orientimin e politikave të reduktimit të konsumit dhe për realizimin e objektivave afatgjatë të vendimit.
Neni i ngarkon gjithashtu ministrisë përgjegjëse për mjedisin detyrën e monitorimit të ndikimit mjedisor të këtyre produkteve gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor. Në bazë të rezultateve të këtij monitorimi, ministria mund të propozojë rishikimin dhe përditësimin e masave të parashikuara në strategji dhe plane veprimi, me qëllim përshtatjen e tyre me nivelin e ndotjes dhe zhvillimet mjedisore.
Për më tepër, neni parashikon se masat për reduktimin e konsumit mund të ndryshohen dhe të rishikohen në varësi të ndikimit mjedisor të produkteve plastike njëpërdorimëshe gjatë ciklit të tyre jetësor, përfshirë edhe fazën kur ato shndërrohen në mbetje të hedhura në mënyrë të papërshtatshme në mjedis. Këto masa duhet të synojnë arritjen e një reduktimi të matshëm sasior të konsumit të këtyre produkteve në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në vitin 2030, krahasuar me vitin 2026.
Gjithashtu, neni përcakton parimet që duhet të udhëheqin këto masa, të cilat duhet të jenë të publikuara, proporcionale dhe jodiskriminuese. Në përmbajtjen e tyre, ato duhet të përfshijnë objektiva kombëtarë për reduktimin e konsumit, masa që garantojnë disponueshmërinë e alternativave të ripërdorshme në pikat e shitjes për konsumatorin përfundimtar, përdorimin e instrumenteve ekonomike, si dhe marrëveshje të parashikuara në kuadër të dispozitave përkatëse të këtij vendimi.
Ky nen synon krijimin e një sistemi të integruar politikash për reduktimin e konsumit të plastikës njëpërdorimëshe, duke kombinuar planifikimin strategjik, monitorimin institucional dhe instrumentet rregullatore dhe ekonomike në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të ekonomisë qarkulluese.

Neni 12 përcakton masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis nga mbetjet e krijuara prej produkteve plastike njëpërdorimëshe, përmes forcimit të sistemeve të grumbullimit të diferencuar dhe mekanizmave të përgjegjësisë së prodhuesit. Këto masa synojnë rritjen e normave të mbledhjes së mbetjeve dhe

përmirësimin e menaxhimit të tyre në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese.
Në këtë kuadër, prodhuesit e produkteve plastike njëpërdorimëshe të listuara në Pjesën F të Shtojcës I detyrohen të organizojnë skema të grumbullimit të diferencuar, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Këto skema synojnë të sigurojnë një sistem efektiv të mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve të gjeneruara nga këto produkte, duke reduktuar sasinë e tyre që përfundon në mjedis.
Gjithashtu, neni parashikon se sasia e produkteve plastike njëpërdorimëshe të hedhura në treg në Shqipëri konsiderohet e barabartë me sasinë e mbetjeve të krijuara nga këto produkte në të njëjtin vit, përfshirë edhe mbetjet e hedhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim shërben si bazë për llogaritjen dhe organizimin e përgjegjësive të prodhuesve në kuadër të sistemit të menaxhimit të mbetjeve.
Në vijim, për këto produkte zbatohet sistemi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, i kombinuar me sistemin e kthimit të depozitës (DRS), me qëllim sigurimin e arritjes progresive të një objektivi minimal prej 90 për qind në peshë për grumbullimin e diferencuar deri në vitin 2035. Këto instrumente synojnë të rrisin shkallën e rikuperimit të materialeve plastike, të ulin ndotjen mjedisore dhe të forcojnë përgjegjësinë e prodhuesve për ciklin jetësor të produkteve të tyre.
Ky nen kontribuon në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve plastike njëpërdorimëshe, duke vendosur mekanizma të detyrueshëm institucionalë dhe ekonomikë që mbështesin objektivat e reduktimit të ndotjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese.

Neni 13 përcakton masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis përmes zbatimit të parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR) për produktet plastike njëpërdorimëshe dhe pajisjet e peshkimit që përmbajnë plastikë. Dispozita synon forcimin e përgjegjësisë financiare dhe organizative të prodhuesve gjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve dhe përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit.
Në këtë kuadër, subjektet që hedhin në treg në Shqipëri produktet plastike njëpërdorimëshe të listuara në Pjesën E të Shtojcës I detyrohen të krijojnë dhe të zbatojnë skema të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, në përputhje me ligjin nr. 74/2025 “Për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesve të produkteve që gjenerojnë mbetje” dhe ligjin nr. 57/2025 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”. Këto skema përbëjnë mekanizmin kryesor institucional për financimin dhe organizimin e menaxhimit të mbetjeve të krijuara nga këto produkte.

Neni përcakton gjithashtu detyrimin e prodhuesve për mbulimin e kostove që lidhen me informimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve, si dhe pastrimin e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme që rrjedhin nga këto produkte. Këto kosto përfshijnë edhe transportin dhe trajtimin e mëtejshëm të mbetjeve, duke siguruar që përgjegjësia financiare e prodhuesve të mbulojë fazat kryesore të menaxhimit të mbetjeve.

Për kategori të caktuara produktesh, neni parashikon gjithashtu detyrime shtesë, përfshirë mbulimin e kostove të mbledhjes së të dhënave dhe raportimit, si dhe financimin e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e mbetjeve, në përputhje me parimet e kosto-efektivitetit dhe transparencës. Kostot e pastrimit të mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme kufizohen në aktivitetet e ndërmarra nga autoritetet publike ose në emër të tyre dhe shpërndahen sipas parimit "ndotësi paguan".
Neni vendos gjithashtu detyrime për subjektet ekonomike që operojnë në treg ndërkufitar, duke kërkuar emërimin e një përfaqësuesi të autorizuar në rastet e prodhuesve të vendosur jashtë Shqipërisë që furnizojnë tregun vendas, si dhe për prodhuesit vendas që shesin produktet e tyre në tregjet e tjera të Bashkimit Evropian. Këto masa synojnë garantimin e zbatimit efektiv të detyrimeve të EPR në të gjitha rastet e tregtimit.
Për më tepër, për pajisjet e peshkimit që përmbajnë plastikë, neni përcakton krijimin e skemave të veçanta të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, përfshirë arritjen e një norme minimale grumbullimi prej 70 për qind për riciklim dhe mbulimin e kostove të grumbullimit, transportit, trajtimit dhe ndërgjegjësimit. Këto masa synojnë reduktimin e ndotjes detare dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve nga aktiviteti i peshkimit.
Në tërësi, ky nen përbën një nga shtyllat kryesore të mekanizmit financiar dhe institucional të vendimit, duke zbatuar parimin "ndotësi paguan" dhe duke siguruar përfshirjen aktive të prodhuesve në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve plastike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe standardet e Bashkimit Evropian.
Kostot e grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve: Prodhuesit e produkteve të listuara në Pjesën E të Shtojcës I janë të detyruar të mbulojnë drejtpërdrejt kostot e grumbullimit në sistemet publike, duke përfshirë infrastrukturën kosto-efektive, transportin, trajtimin dhe funksionimin e koshave specifikë në zona me densitet të lartë mbetjesh. Grumbullimi i diferencuar dhe i izoluar i këtyre mbetjeve parandalon dërgimin e tyre në landfille të hapura apo djegien e pakontrolluar,

duke reduktuar emetimet e gazrave serrë dhe duke parandaluar degradimin e plastikës në mikroplastikë sekondare që infekton tokën bujqësore. Ky sistem transferon tërësisht barrën e madhe financiare të menaxhimit të mbetjeve plastike nga buxhetet e bashkive dhe taksapaguesit e thjeshtë drejtpërdrejt te bizneset që i hedhin këto produkte në treg, duke internalizuar kostot mjedisore.

Kostot e pastrimit të mjedisit (mbetje të hedhura paligjshëm): Sipas germës c të pikës 2 të nenit 8 dhe pikës 5 të nenit 8, prodhuesit duhet të mbulojnë edhe kostot e pastrimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve të skartuara apo të hedhura në mënyrë të paligjshme në hapësirat publike dhe natyrë (*littering*). Ky detyrim penalizon financiarisht ndotjen dhe nxit pastrimin e shpejtë të mjediseve bregdetare dhe lumore, gjë që ndalon fragmentimin e mbetjeve në mikrogrimca përpara se ato të transportohen drejt hapësirave ujore, ku kapja ose filtrimi i tyre teknik bëhet i pamundur..

Kostot e sistemit DRS (Deposit Return System): Përcakton që të gjitha kostot që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e skemës së kthimit të depozitës duhet të llogariten në mënyrë transparente dhe të mos kalojnë kufijtë e nevojshëm për ofrimin kosto-efektiv të shërbimit. Ky funksion garanton një rrjedhë materiale të pastër dhe të pandotur nga mbetjet organike, gjë që mundëson riciklimin e vërtetë me cikël të mbyllur dhe redukton ndjeshëm sasinë e mikroplastikës që përfundon në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza. Ky rregull synon të parandalojë transferimin e kostove të paarsyeshme administrative apo operative tek konsumatorët finalë, duke shmangur shtrembërimet e tregut, pozitat monopol dhe rritjen artificiale të çmimeve të produkteve bazë.

Detyrimet specifike për pajisjet e peshkimit: Pika 9 e Nenit 13 vendos detyrime specifike dhe të rrepta të EPR-së për prodhuesit dhe importuesit e pajisjeve të peshkimit që përmbajnë plastikë, duke kërkuar arritjen e një norme minimale grumbullimi të diferencuar prej 70% në peshë në porte për riciklim. Ky detyrim synon eliminimin e **"rrjetave fantazmë"** (*ghost gear*) të humbura në det, të cilat përveçse vrasin faunën detare, u nënshtrohen forcave të fërkimit nga dallgët dhe kripa, duke u kthyer në një nga burimet kryesore të prodhimit të mikroplastikës primare dhe fibrave sintetike në det. Kjo kërkesë ngarkon sektorin e peshkimit dhe industrinë mbështetëse me kosto logjistike shtesë për ngritjen e impianteve të grumbullimit në zonat portuale dhe menaxhimin e mbetjeve të anijeve të peshkimit. Transpozimi i këtij neni kryhet në mënyrë integrale me Nenin 8 të Direktivës SUP, duke sjellë për herë të parë në Shqipëri skemat moderne të përgjegjësisë prodhuese sipas standardit evropian.

Neni 14 përcakton parimet e koordinimit të masave të parashikuara në nenet 4 deri në 9 të këtij vendimi, në raport me kërkesat e legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit publik. Kjo dispozitë synon të sigurojë zbatimin e njëtrajtshëm të masave kufizuese dhe teknike për produktet plastike njëpërdorimëshe, pa cenuar standardet e higjienës dhe sigurisë ushqimore.

Në këtë kuadër, parashikohet që zbatimi i kërkesave lidhur me ndalimet, kufizimet, dizajnin e produkteve, etiketimin dhe masat e tjera rregullatore të mos kompromet ojë sigurinë e materialeve që bien në kontakt me ushqimin, duke ruajtur nivelin e kërkuar të mbrojtjes së konsumatorit.
Gjithashtu, neni inkurajon përdorimin e alternativave të qëndrueshme ndaj produkteve plastike njëpërdorimëshe, veçanërisht për materialet që përdoren në kontakt me ushqimin, aty ku kjo është e mundur dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe shëndetësore. Kjo qasje synon të nxisë reduktimin gradual të përdorimit të plastikës, duke garantuar njëkohësisht ruajtjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore.
Në tërësi, kjo dispozitë vendos një balancë ndërmjet objektivave mjedisore dhe kërkesave të sigurisë ushqimore, duke siguruar që masat e këtij vendimi të zbatohen në mënyrë koherente me kuadrin ligjor ekzistues dhe pa krijuar pengesa për funksionimin e tregut të produkteve ushqimore.

Neni 15 përcakton institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, si dhe organizimin e sistemeve të informacionit, monitorimit dhe raportimit, me qëllim garantimin e një zbatimi efektiv dhe të koordinuar të masave të parashikuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Në këtë kuadër, ministria përgjegjëse për mjedisin ka rol qendror në hartimin e kuadrit metodologjik për llogaritjen dhe verifikimin e reduktimit të konsumit të produkteve plastike njëpërdorimëshe, si dhe në përcaktimin e rregullave për verifikimin e arritjes së objektivave për përmbajtjen e ricikluar në kontejnerët e pijeve. Po ashtu, ajo përcakton kriteret për klasifikimin e enëve ushqimore si produkte plastike njëpërdorimëshe dhe miraton formatet standarde të raportimit të të dhënave nga subjektet që hedhin në treg këto produkte.
Agjencia Kombëtare e Mjedisit ngarkohet me monitorimin në nivel kombëtar të produkteve plastike njëpërdorimëshe të hedhura në treg dhe të masave për reduktimin e konsumit të tyre, si dhe me administrimin e sistemit kombëtar të informacionit dhe raportimit. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e

raportit vjetor mbi zbatimin e këtij vendimi, i cili përfshin të dhëna mbi tregun e produkteve plastike, masat e zbatuara për reduktimin e konsumit, shkallën e grumbullimit të mbetjeve, përmbajtjen e ricikluar në shishet e pijeve, si dhe informacion mbi pajisjet e peshkimit që përmbajnë plastikë dhe mbetjet e tyre. Në këtë kuadër, sigurohet edhe kontrolli i cilësisë së të dhënave të raportuara.

Në nivel vendor, bashkitë kanë përgjegjësi për organizimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve plastike njëpërdorimëshe, zbatimin e masave për reduktimin e konsumit në territorin e tyre, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, si dhe monitorimin e territorit për parandalimin e hedhjes së paligjshme të mbetjeve. Ato raportojnë periodikisht pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi ecurinë e zbatimit të objektivave dhe të dhënat përkatëse të menaxhimit të mbetjeve.
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka rol të rëndësishëm në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për importin e produkteve plastike njëpërdorimëshe, duke siguruar informacion të saktë mbi sasitë dhe peshën e produkteve të hedhura në treg, në funksion të monitorimit dhe analizës së tregut.
Për zbatimin dhe kontrollin e këtij vendimi, strukturat inspektuese në fushën e mjedisit ushtrojnë mbikëqyrje dhe verifikim në terren, duke vlerësuar nëse produktet klasifikohen si plastikë njëpërdorimëshe në bazë të karakteristikave të tyre funksionale dhe mënyrës së përdorimit. Ky vlerësim synon të sigurojë një zbatim të unifikuar dhe efektiv të dispozitave ligjore.
Në tërësi, ky nen krijon një sistem të integruar institucional dhe informativ që garanton monitorimin e vazhdueshëm të tregut, raportimin e standardizuar të të dhënave dhe kontrollin efektiv të zbatimit të masave për reduktimin e ndikimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe në mjedis.

Neni 16 përcakton organet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, duke garantuar një qasje të koordinuar institucionale në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e masave të parashikuara në të. Në këtë kuadër, ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, bashkitë, strukturat përgjegjëse të inspektimit në fushën e mjedisit, si dhe autoritetet doganore, secila në përputhje me kompetencat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.
Këto institucione sigurojnë zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e masave të vendimit, duke kontribuar në funksionimin efektiv të kuadrit rregullator për reduktimin e ndikimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masave, listës së produkteve plastike njëpërdorimëshe të cilat ndalohet të përdoren, të hidhen në treg, të prodhohen ose të importohen, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe”.

Neni 17 përcakton se dispozitat e këtij vendimi që lidhen me detyrime, procedura, mekanizma ose marrëdhënie juridike të zbatueshme vetëm për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose që ushtrohen në bashkëpunim me institucionet e Bashkimit Evropian, zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 18 përcakton hyrjen në fuqi të vendimit pas publikimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa efektet e tij të zbatimit fillojnë nga data 1 korrik 2028. Ky afat synon të krijojë një periudhë të përshtatshme tranzitore për përshtatjen e subjekteve të prekura dhe përgatitjen e institucioneve përgjegjëse për zbatimin efektiv të dispozitave të këtij vendimi.

Shtojca I përmban listën e detajuar të produkteve plastike njëpërdorimëshe, të ndara sipas kategorive funksionale. Ajo përcakton produktet që i nënshtrohen reduktimit të konsumit, ato që ndalohen në treg, produktet për të cilat vendosen kërkesa teknike, produktet që i nënshtrohen etiketimit, si dhe ato që përfshihen në skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, grumbullimit të diferencuar dhe masave ndërgjegjësuese.

Shtojca II përmban specifikimet teknike të detajuara për etiketimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe. Ajo përcakton mënyrën e vendosjes së shënjimeve, madhësinë, dizajnin, ngjyrat dhe përmbajtjen e tyre për kategori të ndryshme produktesh, si pecetat higjienike, pecetat e lagura, produktet e duhanit me filtra dhe gotat e pijeve, me qëllim sigurimin e një informimi të qartë dhe të standardizuar për konsumatorët.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij projektvendimi janë Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Doganat, Inspektoriati Përgjithshëm dhe Bashkitë e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij ligji.

Sofjan Jaupaj
Digitally signed by Sofjan Jaupaj
Date: 2026.[illegible] +02'00'

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masave, listës së produkteve plastike njëpërdorimëshe të cilat ndalohet të përdoren, të hidhen në treg, të prodhohen ose të importohen, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe".

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar Drejtoria e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Drejtoria e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.
Projektvendimi është hedhur për mendim në faqen e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në datën 02.11.2026, dhe numri i shikimeve është 184, numri i komenteve është zero.
Projektvendimi do dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministër Shteti dhe Kryenegociator, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Inspektoriatit të Përgjithshëm.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ndikimi në buxhetin qendror
Projektvendimi nuk parashikon krijimin e fondeve të posaçme apo transfertave buxhetore nga buxheti i shtetit për financimin e masave të përcaktuara në nenin 13. Institucionet qendrore përgjegjëse për mjedisin do të mbulojnë, në kuadër të strukturave dhe buxheteve ekzistuese, aktivitetet që lidhen me hartimin e akteve nënligjore, monitorimin e zbatimit të skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, administrimin e të dhënave dhe raportimin kombëtar. Për rrjedhojë, ndikimi në buxhetin qendror vlerësohet i kufizuar dhe me karakter kryesisht administrativ.
Ndikimi në buxhetin vendor
Njësitë e vetëqeverisjes vendore vijojnë të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit publik. Megjithatë, në zbatim të parimit "ndotësi paguan" dhe të skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, kostot që lidhen me grumbullimin, transportin, trajtimin dhe pastrimin e mbetjeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe të mbuluara nga ky vendim përballohen nga prodhuesit. Si rezultat, projektvendimi pritet të ulë gradualisht barrën financiare që aktualisht rëndon mbi buxhetet vendore për menaxhimin e këtyre mbetjeve. Kostot e mbetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhen kryesisht me koordinimin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve përkatëse.
Ndikimi në biznes

Projektvendimi krijon detyrime financiare të drejtpërdrejta për prodhuesit dhe subjektet që hedhin në treg produktet plastike njëpërdorimëshe të listuara në Shtojcën I, si dhe për prodhuesit e pajisjeve të peshkimit që përmbajnë plastikë. Këto subjekte janë të detyruara të krijojnë ose të marrin pjesë në skema të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe të mbulojnë kostot përkatëse.
Kostot e biznesit përfshijnë:
Krijimin dhe funksionimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit: Ky detyrim parashikon financimin e plotë të strukturave menaxhuese të skemave të EPR-së, të cilat krijohen, licencohen dhe operojnë si subjekte private të financuara ekskluzivisht nga kuotat e detyrueshme të prodhuesve dhe importuesve, pa asnjë implikim për buxhetin publik.
Financimin e masave të informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut: Ndërsa njësitë e vetëqeverisjes vendore mbajnë të drejtën të zhvillojnë fushata të lokalizuara të edukimit mjedisor, financimi i masave dhe fushatave me shtrirje kombëtare për parandalimin e ndotjes nga plastika njëpërdorimëshe përballohet tërësisht nga sektori i biznesit përmes kontributeve në skemat e EPR-së. Ministria përgjegjëse për mjedisin mban vetëm rol rregullator dhe miratues të kritereve teknike të këtyre fushatave, pa pasur asnjë kosto financiare zbatimi.
Kostot e grumbullimit të mbetjeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe, përfshirë infrastrukturën përkatëse: Ky përcaktim detyron biznesin të mbulojë investimet për mjetet e punës që përdoren për këtë rrjedhë specifike mbetjesh. Blerja e koshave të diferencuar për ambalazhet, shishet apo gotat plastike, si dhe vendosja e tyre në pikat e grumbullimit, financohet drejtpërdrejt nga operatorët ekonomikë dhe nuk rëndon mbi buxhetet e vetëqeverisjes vendore.
Kostot e transportit dhe trajtimit të mbetjeve: Edhe në rastet kur njësia e vetëqeverisjes vendore ose operatori i saj i kontraktuar kryen lëvizjen fizike të mbetjeve, kostot operacionale që lidhen me karburantin, amortizimin e mjeteve dhe tarifat e pranimit në impiantet e trajtimit apo riciklimit për këtë rrjedhë mbetjesh nuk përballohen nga buxheti i bashkisë, por i faturohen skemës përkatëse të EPR-së për rimbursim të plotë mbi bazën e parimit kosto-efektiv.
Kostot e pastrimit të mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme (littering) dhe trajtimit të tyre pasues: Ky parashikim ndryshon modelin e financimit të pastrimit të mjedisit, duke specifikuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore mbajnë vetëm përgjegjësinë operacionale për kryerjen e aksioneve të pastrimit në territor, ndërsa çdo kosto financiare që lidhet me burimet njerëzore dhe logjistikën e angazhuar për menaxhimin e këtyre mbetjeve të paligjshme rimbursohet plotësisht nga skemat e EPR-së të financuara nga biznesi.

Kostot e mbledhjes së të dhënave, monitorimit dhe raportimit: Ky funksion përbën një detyrim tërësisht rregullator të vetë skemave të EPR-së dhe adituesve të tyre të pavarur. Meqenëse njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë kompetencë apo infrastrukturë teknologjike për gjurmueshmërinë e produkteve të hedhura në treg, ngritja e sistemeve të informacionit (IT) dhe raportimi vjetor pranë Ministrisë apo Agjencisë Kombëtare të Mjedisit financohen ekskluzivisht nga sektori privat.

Kostot për ngritjen e infrastrukturës së posaçme të grumbullimit, kur kjo është e nevojshme: Për mbetje specifike si ato të produkteve të duhanit me filtër, kërkohet ngritja e një infrastrukture të dedikuar (si kosha apo rregullime specifike në zona me fluks të lartë). Këto kosto nuk përfshihen në shërbimet standarde të menaxhimit të mbetjeve urbane të bashkisë dhe përballohen tërësisht nga prodhuesit dhe importuesit e kësaj industrie.

Kostot që lidhen me emërimin e përfaqësuesve të autorizuar për prodhuesit që operojnë nëpërmjet shitjeve në distancë: Ky detyrim rregullon marrëdhëniet e tregtisë ndërkombëtare dhe shitjeve online (*e-commerce*). Ky detyrim administrativ dhe ligjor rëndon vetëm mbi kompanitë e huaja që furnizojnë tregun shqiptar dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar në Republikën e Shqipërisë, pa pasur asnjë ndikim në funksionet apo buxhetin e autoriteteve publike.

Kostot për arritjen e objektivave të grumbullimit dhe riciklimit të pajisjeve të peshkimit që përmbajnë plastikë: Menaxhimi i mbetjeve të pajisjeve të peshkimit realizohet në impiante të posaçme pritëse në hapësirat portuale dhe nuk përfshihet në rrjedhën e mbetjeve urbane të bashkive. Kjo kosto e re mjedisore për arritjen e objektivit ligjor prej 70% grumbullim në peshë rëndon tërësisht mbi industrinë e peshkimit dhe skemat përkatëse të EPR-së.

Për rrjedhojë, ndikimi financiar kryesor i projektvendimit bie mbi sektorin privat, në përputhje me parimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe parimin "ndotësi paguan", ndërsa ndikimi mbi buxhetin qendror dhe vendor mbetet kryesisht administrative-rregullator dhe mbikëqyrës.

M I N I S T R I

Sofjan JAUPAJ

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masave, listës së produkteve plastike njëpërdorimëshe të cilat ndalohet të përdoren, të hidhen në treg, të prodhohen ose të importohen, institucionet shtetërore përgjegjëse dhe miratimin e kritereve dhe masave të nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe".